



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 386/ Prot.

Tiranë, më 13/10/2015

Lënda : Në lidhje me publikimin e të dhënave personale nëpërmjet aplikacionit apo portalit për denoncimin e problematikave në fushën tatimore.

Drejtuar: Znj. Milena HARITO

**MINISTËR I SHTETIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN
PUBLIKE**

Tiranë

E nderuar znj. Harito,

Zyra e Komisionerit, ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj për mendim në lidhje me publikimin e të dhënave personale nëpërmjet aplikacionit apo portalit për denoncimin e problematikave në fushën tatimore dhe në këtë kuadër lutemi, referohuni në interpretimin ligjor përkatës.

Në bazë të nenit 3 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, me termin "*e dhënë personale*" nënkuptohet çdo informacion në lidhje me një person fizik.

Është e rëndësishme të theksojmë se përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë në përputhje me një nga kushtet e parashikuara në nenin 6) të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Vetëm në këtë rast përpunimi do të konsiderohej i ligjshëm.

Përveç faktit që ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk i referohet subjekteve juridik, vlerësojmë gjithashtu, se emrat e bizneseve, pavarësisht statusit tregtar (person fizik ose juridik), janë të dhëna publike të pasqyruara në Regjistrin Tregtar që administrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) në përmbushje të një detyrimi ligjor të këtij kontrolluesi dhe mund të aksesohen lehtësisht nga çdo qytetar (të dhëna haptazi publike).

Ndërkohë, në lidhje me të dhënat e mbledhura nga denoncimet (të dhëna të qytetarëve denoncues, përdoruesve të portalit etj.,) me qëllim përpunimin e tyre, kontrolluesit (autoriteti që zotëron dhe administron aplikacionin apo portalin), i lind detyrimi që paraprakisht të plotësojë detyrimin për njoftim, parashikuar në nenin 21 të ligjit pranë Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesit i lind detyrimi që të informojë subjektet e të dhënave personale (denoncuesin dhe të denoncuarin) lidhur me të drejtat që gëzojnë në bazë të nenit 18 të ligjit. Sugjerojmë që ky detyrim të realizohet nëpërmjet publikimit të “politikave të privatësisë” në përmbajtje të aplikacionit apo portalit, përpara hedhjes së të dhënave në të.

Në cilësinë e kontrolluesit, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet që të hartoni dhe miratoni “Politikën e Sigurisë së Informacionit” (kjo e fundit është tërësi rregullash mbi sigurinë teknike të përpunimit të të dhënave në një sistem elektronik), në zbatim të Udhëzimit nr. 21, datë 24.09.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” i ndryshuar dhe nenit 27 të ligjit.

Në zbatim të shkronjës d) të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, ju lind detyrimi që të përcaktoni afate lidhur me mbajtjen e të dhënave. Afati duhet të lidhet me qëllimin e përpunimit të të dhënave dhe me realizimin ose përmbushjen e qëllimit.

Publikimi i këtyre të dhënave duhet të kryhet në përputhje edhe me nenin 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” në të cilin parashikohen kufizimet e të drejtës për informim. Është detyrë e vetë kontrolluesve (institucioneve publike ose private) që të gjejnë balancën e duhur midis të drejtave.

Besnik DERVISHI

